

QEMAL STAFĀ

BIBLIOTEKA E NXENËSIT

QORTIMET
E VJESHTËS

Shkrime letrare

SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT SHKOLLOR
TIRANË, 1975

TRASHËGIMI LETRAR I QEMALIT

Mbledhur e pajisur me shënimë nga
Nasho Jorgaqi

Kur rri e mendon për Qemalin, ndjen se në figurën e tij janë bashkuar madhështia e heroit me burrérinë e luftëtarit, bukuria e talentit me thjeshtësinë e njeriut. Tek ai janë shkrirë në një: njeriu, komunisti, letrari.

Qemali nuk qe një fenomen i shkëputur në historinë shqiptare. Ai lindi në gjirin e lëvizjes sonë revolucionare, u brumos e u formua që në rininë e parë me mendimin marksist; atë e ngriti në rolin e militantit të shquar Partia Komuniste Shqiptare.

Qemali jetoi gjithsej njëzet e një vjet, dhe, duke e njohur nga afër jetën e tij, kupton se sa shumë mund t'i shërbejë njeriu çeshtjes së revolu-



2

Qemali nisi tē debutojē nē letërsi nē një moshë fare tē re, kur ishte pothuajse ende fëmijë. Duke genë nga natyra i zgjuar e i hollé, i ndjeshëm e studjuas, vërejtës e këmbëngulës, talenti i tij spikati dhe ai krijoj qysh herët shkrime letrare që tèrroqën vëmendjen dhe merituan lavdërimë. Kontakti i drejtëpërdrejtë me jetën e vështirë tē popullit, përqaftimi i ideve revolucionare, leximi i letërsisë përparimitare, i hapën atij horizonte tē reja dhe i ushqyen talentin.

Provat e para të Qemalit letrar janë hartimet e bukurë që shkroi në bankat e shkollës. Këto punë modeste u gjuan që atëherë nga mësuesit dhe shokët e tij. Ndonjë prej tyre bëri jehonë dhe jash-të klasës. Për këtë Qemali pati dhe pasoja si nxënës. Shkrimet letrare të Qemalit janë një shembull i shkëlqyer se si ky revolucionar i ri edhe në punët shkollore derdhi mendime të fuqishme, su-lej me urrejtje kundër shtetit shtypës feudobor-gjez dhe shprehte dashurinë e flaktë për masat po-pullore.

Pas hartimeve, me punë këmbëngulëse Qemali kaloi në krijime të vërteta letrare. Disa, dhe këto qenë pak, i botoi në shtypin përparimtar të kohës, kurse piesa më e madhe mbeti në dorëshkrim.

Që në fillim, Qemali e mori letërsinë më dashuri e seriozitet. Ai e kuptoi me kohë se letërsia nuk është një mjet argëtimi. Që në moshën pësembdhjetë vjeçare, si nxënës ai shkruante: «Arti i deritashëm, që, veç trajtës së bukur, nuk ka tjetër cilësi, nuk i përmbrush nevojat tona. Ç'më

onit kur gjithë forcat e veta ia kushton idealit komunizmit edhe në kaq pak vite jete. Qemaliundi që, brenda një kohe jashtëzakonisht të kurtër, të punojë e të luftojë në shërbim të kë-tij. Dhe, kur ai u nda para kohe nga radhët e aftetarëve, vdekja e tij qe një humbje e rëndë, jo atëtëm për gardën e komunistëve që po ngrimin atë-erë popullin në këmbë, por edhe për letërsinë to-je revolucionare, së cilës iu shkëput një talent njësht premtues. Krijimet më të mira të Qemalit nën pjesë në përpjekjet e atyre shkrimitarëve për-parimtarë që po i hapnin letërsisë shqipe horizonte reja ideoartistike. Letrari i ri revolucionar qmon-je rolin e fjälës artistike si mjet lufte për përhap-jen e mendimeve të reja. Dhe ai vetë dha një shembull të mirë, duke ia nënshtruar këtij qëllimi fisionik gjithë sa shkroi.

Trashëgimi letrar i Qemalit, sado i paktë, bart nё vëtvete një pjesë të botës së tij të madhe. Shkrimet që la ai janë vetëm disa shkëndija të flakës që i përftonin idetë e larta që e udhëhiqnin në jetë, shkëndija të shpirtit të zjarrtë revolucionar, të emocioneve të thella e të interesave të gjithanëshme që ai kishte, gjithnjë me prirje nga e vërteta komuniste dhe e drejta e popullit.

Qemali nuk arriti dot të shprehte gjithë sa dëshironte. Ai zhvillonte një veprimtari të gjith-anashme revolucionare dhe nuk i mbetej fare kohë për krijimtari letrare. Kënga e tij u këput që në hovet e para, tek merrte fluturim. Dhe ajo mbeti përjetë këngë hovesh të para!

duhet mue një poezi e bukur në trajtë, por e vor-fën në idena?»

Prandaj shkrimtari, sipas Qemalit, në rast se do që vepra e tij të ketë vlerë e tu shërbejë një rëzve, duhet që në themel të saj të vërvë ide të shëndosha, të pasqyrojë realisht shoqërinë e ndarë në klasa, të luftojë padrejtësitë shoqërore, të bëjë hero të vetin njerëzit e vuajtur të popullit. Dhe kur lexon shkrimet e Qemalit, e ndjen se tema kryesore e tyre është mjerimi i popullit shqiptar, pakënaqësia dhe revolta ndaj rendit të asaj kohe.

Le t'i kujtojmë lexuesit skicën e njojur «Qor-timet e vjeshtës», që me të drejtë mund ta quanim si një kredo të Qemalit letrar. Duke na dhënë fatin e mjerë të një gështenjëpjekësi plak, nëpermjet skenash të thjeshta, por shprehëse, me detaje të gjetura, me një notë dhimbjeje e proteste fëmino-re, Qemali mban hapur anën e njerëzve të thjeshtë dhe ngrihet me zemërим kundër padrejtësive shoqërore. Ideja e shëndoshë që e përshkon gjithë skicën qartësohet edhe më mirë në fund, kur mby-llet me këto fjälë:

«U largova me një premtim dhe një dënim
në zemrën time. Dënova shoqërinë njerëzore;
premtova...» Por te njerëzit e thjeshtë, të
vuajtur e të dërmuar nga hallet dhe shtypja Qe-
mali futet thellë, zbulon botën e madhe të këtyre
njerëzve, krenarinë dhe pastërtinë e ndjenjave,
qëndresën burrërore dhe besimin tek e ardhmja:
Duke zbuluar të tilla tipare Qemali shpreh në
shkrime edhe gjëzimin e tij të thellë, edhe besimin
që i jepin këta njerëz.

Nota kryesore e krijimeve të Qemalit është revolta, qëndresa. Autori i ri tërhiqet jo aq nga mjerimi, se sa nga lufta për të mos u pajtuar me padrejtësitet shoqërore. Ai kërkon tă japë figura njerëzish që nuk mposhten para vështirësive e që me stoicizëm u qëndrojnë besnik idealeve të veta. I tillë është detari i skicës «Nënshtypje kaltërsie», i cili, i rrahur e i kalitur nga furtunat e jetës, me besim të patundur në forcat e veta, refuzon çdo mëshirë e lëmoshë. «Ai nuk kërkon mëshirë — shkruan autori. — Porsa dallon një gjurmë të leh-të keqardhjeje mbi fytyrën time, qesh e këndon me za. Përmes gojës së tij më flasin mijëra burra që bajnë të njëjtën jetë». Qemali do t'u paraqesë bashkëkohësve të vet, si shembull që të ndiqet në jetë, një njeri të tillë ku spikat forca dhe qëndresa.

Simpatia pér njerëzit që ndiqeshin e burgoseshin nga qeveritarët, e ka shtyrë autorin të ravijë zojë portretin e një të burgosuri në skicën letrare «Reze frëngjijash».

Mjaft interesant e i përshkuar nga mendimet materialiste paraqitet shkrimi «Portreti i Skënderbeut». Pasi karakterizon drejt figurën e Héroïtonë Kombëtar, Qemali nänvizon, ndërmjet të tjerash, se udhëheqësi i vërtetë i popullit duhet t'i shembellejë Skënderbeut dhe se pas një prisi të tillë cdo njeri është gati të vdesë. Aluzioni i autorit për kohën është i qartë; përparrë personalitetit të madhërishëm të Skënderbeut, Zogu, që ishte vetë shpallur mbret e që shtypte popullin, s'ishte gjë tjetër, veçse një karnaval.

Për ide mjaft të përparuara, në një moshë fare të re, dëshmon shkrimi i njohtur i Qemalit «E

vjetra shembet, kohët po ndryshojnë; një jetë e re po lulëzon gërmadhash». Aty është sintetizuar gjithë botëkuptimi i komunistit të ardhshëm. Edhe pse është shkruar në një moshë fare të re, ky hartim të habit me pjeturinë e mendimet revolucionare, të shprehura aq qartë dhe në mënyrë shumë të guximshme.

Ai shpall me guxim që në bankën e shkollës: «... asht gja e domosdoshme ta ndryshojmë ndamjen e sotme të pasunisë (gja e vjetër) e ta zavendësojmë me një ndamje të dytë e të njinjishmë (gja e re). Rusët⁴) e kanë ba që me kohë: shembull ky se e vjetra shembet. Edhe ne do ta bajmë».

Ky shkrim tē prek pér thellësinë e imprehtesinë e mendimeve, pér formimin e parakohshëm, pér horizontin dhe talentin. Iskte vetëm pesëmbëdhjetë vjeç kur shprehet kështu, e kërkonte, në emër të brezit tē ri që po vinte, ndryshime në themel tē shoqërisë shqiptare. Në këtë shkrim del bësimi që ai ka në realizimin e këtyre idealeve tē mëdha.

«Vetëm të riktë mund ta organizojnë një shqipëri të re shqiptare — shkruan Qemali në artikullin «Qëllimi ynë — thomi të rintjtë, pse tue mos pasun lidhje me të shkuemen, vetëm ata janë në gjendje me i shikue çështjet me syun e kohës sonë. Thomi të riktë pse vetëm ata janë në gjendje me i shti në punë energjitet e tyne të reja për një punim sistematik, pse janë të zhveshun prej mbeturinave të kohëve të kalueme».

Megijthëse ishte shumë i ri, këto mendime e

1) Është fjala për revolucionin e Tetorit 1917. Pra, Qemali shpreh hapur dëshirën për një revolucion socialist.

radhisin Qemalin me brezin e shkrimitarëve përparimtarë të viteve 30. Ai, si nga idetë, ashtu dhe nga trajtat që mori letërsia asokohe, ishte i afërt me ta. Kështu, në këto vite, Qemali, në shembullin e Migjenit e të të vëllait, Veliut, që shkruante me pseudonimin Platonicus, lavroi Ilojet e vogla të prozës tregimtare si skicën, portretin etj. Me një gjuhë figurative, shpesh alegorike, në mënyrë konçize, në këto shkrime goditeshin shfaqje negative të jetës shoqërore. Qemali batoi disa nga ato, duke ngritur probleme shoqërore, si nevojën për të luf-tuar kundër fanatizmit e robërimit të gruas shqiptare, demaskoi bestytnitë e sharlatanizmat e Kle-rit etj.

Për Qemalin mund të thoshim se është më te-për poet se sa prozator. Këtë e tregon, në radhë të parë, fakti se krijimet e tij më të pjekura artistikisht janë vjershat. Po dhe prozat e tij, nga mënyra se si janë shkruar, nga nota poetike që i përshkon, nga gjuha figurative e lalonike, mund t'i quanim me të drejtë proza poetike.

Vjersha e parë që njohim nga Qemali është «Kënga e kumbanores». Duke vënë në qendër të vjershës figurën e një plaku të munduar nga vuejtjet e uria, ai zbulon para lexuesit kontrastin e fortë shoqëror të kohës; ndërsa një grusht njerëzish «thurin andrime rrëth kumbonës», «mejton ai fëmijtë që bukë pa pra kërkojnë». Kuadri poetik i kësaj vjershe është një copë e gjallë e jetës shkodrane në vitet e rënda të regjimit feudoborgjez e të obskurantizmit fetar.

«... nalt horizonte ngadhnijese na presin». Ky është laitmotivi i vjershës «Shokut të prangave», të cilën Qemali ia kushton Vasil Shantos. Ai i kë-

don luftëtarit të revolucionit, shokut të luftës së përbashkët kundër «fëlliqësinës agallare». Vargjet i përshkon një patos i zjarrtë revolucionar: që e ka burimin te urrejtja ndaj botës së vjetër dhe në besimin për jetën e re, që do të lindë përmes luftës.

Krijimi më i mirë i qenit dñe H. S. K. është bukura të poezisë së revolucionarëshët, padyshim, vjersha «Hijes së tim vlla». Megjithëse e shkruar në një çast të rëndë, në të nuk ndjehet fryma elegjiakë. Poeti nuk vajton për fat-keqësinë që i ka rënë, po himnizon figurën e të vëllait revolucionar. Me një patos të vetëvetishëm ai evokon, nga pozitat e një poeti qytetar, çastet kryesore të jetës së Veliut e, njëkohësisht, veprimtarinë e tyre të përbashkët revolucionare. Duke shkruar këto vargje për Veliun, ai i drejtohet jo aq vëllait, sa shokut të ideve. Sepse të dy vëllezërith kishin marrë me kohë rrugën e luftës, të dy e kishin urvyer e dënuar këtë «shekull të ndytë që ka shkëlqim gjenjeshtar...», të dy nuk ua kishin vënë veshin atyre që thoshin «lodhja e juaj asht e kotë». Ata kishin ecur përpëra me guxim, të vendosur në rrugën e tyre. Por një ditë, papritur, ai ndjeu se Veliu u shkëput nga radhët, vdekja i rrëmbetur shokun dhe vëllanë. Këtë ngjarje ai e konsideroi si rënien e një luftëtarë në betejë e sipër dhe zëvendësimin e tij nga një shok i ri. Në këto caste të vështira, ai nuk u ligështua, po, duke shtrënguar më fort flamurin ndër duar, u betua solemnisht:

*Flamurin
q ' n'zi t ' buk s me lot qendisi nana
e q ' t'pash  un  se vajtove
mos druej, pa krah ai kurr  s'do t ' jesi,
bri timit pror kryenalt  ka me value.*

Këtë betim Qemali e mbajti, sepse tre vjet më vonë, i radhitur në gardën e dyqind komunistëve të parë. I prirë nga flamuri i Partisë Komuniste, ai u vu në krye të luftës së rinisë dhe ra heroikisht në fushën e nderit.

Duke dhënë frymën e fundit në luftë të paepur me armiqtë e popullit, ai linte pas emrin dhei veprën e një heroi e bashkë me to dhe këngët e hoveve të tij të para. Këto këngë, të mbledhura me dashuri e respekt të thelli, po ia paraqesim rishtas lexuesit, duke i bërë tek-tuk ndonjë ndryshim drejt shkrimor.

Nuk ka dyshim se trashëgimi letrar i Qemalit, ashtu si jeta dhe lufta e tij do të mbeten gjithnjë burim frymëzimi për brezat e ri të lexuesve, një shembull i shkëlqyer i shkollarit të pjekur e plot-dijeni që edhe në punët e shkollës derdhët men-dimet e mëdha revolucionare.

Nashq Jorgaqi


HIJES SĒ TIM VLLA!

U linde
n'at vit tē tymosun,
nē dhimbje, kur njerzia
mes vetes si bishë ish kacafytē.
U rrite,
mjerimesh i brumosun.
N'femini ty prore¹⁾ uria
tē mësoi kët shekull t'ndytē
m'e urej't e m'e dënue.
Krenar,
që shkëlqimi gënjeshtar
i kësaj bote t'shkrryeme²⁾
ndër balta monedhore,³⁾
s'mundi
mbas vetes me t'hjekë zvarrë,
Vlla, kur sytë i kthyeme
ndaj tē rejat llogore,
premtuem bashkë na me luftue.

1) orë e gast, gjithnjë

2) fëlliçur

3) nga monedhë, pare



Atëherë,
tē dy na ecëm nëpër botë,
kudo tue pa mjerime
që zemrën peshë na e çojshin.
Na thanë:
«Lodhja juej, djelm, asht e kotë,
pse nuk shkonì ndër gëzime?»
E rrugën tonë m'e premun dojshin,
ata që n'pupla jetën kanë kalue.
Vazhduem.
Shkrepat e vrazhdë tu' kapërcye,
për me arrijtë dikur n'fitore.
Por, ah, se rruga, shok, tē lodhi!
Kujtuem
se n'vrull tē ri jetën me msye
do t'mujshim dorë pér dore,
por, ah, se frymën vdekja tē vodhi
e luftën s'mundëm bashkë m'e vazhdue...
I vetëm
do t'kthehem rishtas n'ato ana
ku lufta që, heu, s'mbarove
n'shkambinj tē rrebta presin.
Flamurin,

që n'zi tē bukës me lot qendisi nana
e që t'pash' unë se vajtove,
mos druej, pa krah ai kurrë s'do t'jesi,
bri timit pror kryenaltë ka me value.

Qemali këtë vjershë ia kushtoi vëllait tē madh, Veliut.
Veli Stafa Lindi në Elbasan më 1915. Kreu Liceun, degën
klasike në Shkodër. Studjoi pér mijekësi në Itali (Bolonja) ku
u diplomua më 1938. Vdiq në moshën 24-vjeçare, në një nga
sanatoriumet e Parisit, më 18 mars 1939.

Veli Stafa u muar aktivisht me letërsi, duke botuar nën
pseudonimin Platonicus. Fryma dhe idetë përparimtare që
përshkoinë veprat e tij, në poezi e në prozë, e radhisin atë në
brezin e shkrimitarëve të rinx të viteve tridhjetë.

Vjersha u shkrua më 1939, kur Qemali ishte në burg i
dënuar nga regjimi i Zogut. Në gjallje të autorit ajo nuk u
botua asnjëherë. Për herë të parë pa dritën e botimit më
1945, në përbledhjen përkujtimore «Qemal Stafa» (Botime
të gazetës «Bashkimi»).

— Vini re se si në këtë vjershë Qemali i këndon tē vë-
llait jo nga pozitat e njeriut tē afërm tē familjes, po në radhë
tē parë si shok tē një idealit e tē një llogorje luftë. Poeti
nënvizu idealet shqërore, urrejtjen pér regjimin shtypës
e grabitqar. Si një betim ushtojnë vargjet ku Qemali i prem-
teton vëllait, shokut tē luftës, se ai do tē jetë vazdimisht luft-
tëtar i idealeve që patën nisur:


«Flamurin
që n'zi tē bukës me lot qendisi nana ... Mos druej,
pa krah ai kurrë s'do t'jesi.»

— Si e jep poeti dashurinë e vëllait dhie tē tijën pér nje-
rézit e varfër e tē shfrytëzuar?

— Ç'kuptim kanë vargjet:
«Lodhja juej, djelm, asht e kotë,
pse nuk shkonit ndër gëzime?»

SHOKUT TË PRANGAVE

Lindun në prakun e nji bote tē ngujuerme
nga epshi i monedhës pérherë e pangime
rritun n'gjuin e nji shoqnie tē frymëzueme
dëshirash tē ulta zemrash tē ngrime,
Filiza tē njomë që n'etje t'agimit
vesën e freskët t'drejtësisë ngushlluese
kërkuem pér birt e shtypun t'mjerimit,
grushtin e ri pranga ngashëruese



pranë grushtit tim ta lidhi n'zinxhirë,
por afshin e zemrës, at kangë djaloshare
q'ushqejti idenë që botës lavire
n'turij me i përplasë flliqsinë agallare.¹⁾

1) fëlligësinë e jetës feudale tē kohës

nuk mujti me shuem n'ankime që vdesin,
 pse nalt horizonte ngadhnjyese na presin.
 Mbi shkambin e gjallë të jetës s'thepisun
 varférinë lakuriqe ta ndriti mjerimi
 buzë bregoresh, vegintar, i molisun
 nga gjumi të zgjojti i vuejtjes ulurimi.
 Përgjumshëm vëzhgove t'artat fushore,
 që lodhja e punës me mund shenjtërojti,
 sodite ti djersën që n'heshqje vapullore²⁾
 mbi ballin e bujkut prej shekuish pikojti.
 Shkrepat e tuej njëherë i harrove thërime,³⁾
 po zemrën
 brengash të vjetra që vazhdueshëm durove
 Filiqsi që ngjalli kaq pshërétime

2) nga vapë, vapa e verës

3) e pakuptueshme në dorëshkrim

Në procesin e gjyqit famëkeq të Tiranës kundër komunistëve shqiptarë (1939) Qemali qëndroi i lidhur në pranga bashkë me Vasil Shanton. Ky fakt i frymëzoit poetit vjershën «Shokut të prangave», që nuk na ka arritur e plotë.
 Vasil Shanto (1913-1944), kandidat i KQ të PKSH, Hero i Popullit, ishte një nga shokët më të dashur të Qemalit. Kjo poezi u botua për herë të parë në gazetën «Zeri i rinisë» më 5 maj 1962.

Në këtë vjershë plot mendime të fugishme, poeti zbulon jo vetëm idealet e mëdha revolucionare të komunistit Vasil-Shanto, po edhe respektin e tij të thellë për njerëzit e thjeshtë të punës, për ato që djersiten dhe vuajnë.
 — Si e shpjegoni vargun: «Nga gjumi të zgjojti i vuejtjes ulurimi.»?

— Duke ditur kur dhe ku është shkruar poezia ç'kuptim ka kushtimi që në titull «Shokut të prangave»?

KANGA E KUMBANARES

N'mëngjezet e ftohta, kur acaria
 agjin ujt' e çatisë,
 i mbledhun, i krrusun del nga shtëpia
 i bir' i urisë.

I randë e i lodhun nga nata e kalueme,
 me gjumë i pangimë,
 drejtohet kah kisha e re e ndërtueme
 plaku i thimë.

Derën e hekurt shtyn me ngadalë,
 ku e presin litaret,⁴⁾
 që tinguj t'argjanta të dalun valë-valë
 përhapin mbi varret.

Por landa kumzore²⁾ peshon pa mëshirë
 mbi krahët e plakut,
 litari i randë e hudhë pa vështirë
 përpjetë varfanjakun.

1) litarët e këmbanave

2) lënda kumbuese

Zorrët e barkut i dalin nga zori,
që frymën i merr,
at frymë që tinguj prej vjetësh nxori
e vuejti në terr.

N'sa djersët e ngrohta mbi ball' i pikojnë,
n'qytetin e heshtun përhapen tinglime,
mejton ai smijtë që bukë pa pra kërkojnë
kur njerzia rrëth kumbonës thur andrrime.

Vjershë e frymëzuar ngajeta e qytetit të Shkodrës, ku Qemali kaloi fëmininë e rininë e tij të parë. Qemali i ri aso kohe kishte shoqëri me heroin e ardhshëm të popullit Ndoc Mazi (1916-1944), i jati i të cilit shërbente si kumbarar kishe. Jeta e tij e vështirë e nxiti Qemalin të shkruejë këtë vjershë.

U botua për herë të parë në 1945 në përmbledhjen përkujtimore «Qemal Stafa».

Me sa dashuri e dhembje është dhënë në këto vargje portreti i njeriut të varfér të munduar e të lodhur nga jetë. Qemali vë në dukje varférinë e vegjelisë qytetare, kushtet e rënda jetësore dhe shfrytëzimin e egër të klasave të pasura.

— Gjeni të gjitha vargjet ku zbulohet vuajtja dhe mijërimi i njeriut të thjeshtë.

— Bëni një hartim me temë: «Feja në të kaluarën, si pjesë e klasave shtypëse, mbante në errësirë njerëzit e punës».



E VJETRA SHEMBET, KOHËT PO NDRYSHOJNË; NJË
JETË E RE PO LULËZON GERMADHASH

Fjalë tē arta, fjalë plot kuptim! Tash sa vjet
duelén rrjedhshém prej pendës së nji idealisti tē
madh. Shilerit, shpirti i tē cilat, i etshém pér
gjana tē reja, ndër tē cilat vendin ma tē parë e ze
liria e popujve, lëshonte za kushtrimi në shkreti-
nën e thatë tē idealizmit tē asaj bote tē vjetë-
rueme ku rronte.

Shiheri e kishte kuptue të vjetrën.

Edhe na e kemi kuptue.

E vjetra asht qđo gja qđe kohnat e kalueme na kanë lanë. Sistemi shoqnuer, arti i dikurshëm, feja, dasia midis popujve, janë të tilla. Njeriu vetvëtiu i prirun nga përparimi, i sheh të metat e kohënave të kalueme dhe dëshiron t'i ndreqë. Këndej zhpiqjet e reja të çuditshme në qđo lamë të kulturës.

Dëshirën e rrënimit të së vjetrës e ka dishmuesku e kur ka pasë: francezi me Revolucionin e madh të Francës, Galileu me ligjin e tij, Lindbergu në udhëtimin prej Amerike në Francë, rusi me ndryshimin e sistemit shoqnier... (borgjezë, hapni veshët mirë!)

Tash tē vërejmë imtësishët e mirë tē gjitha sendet e vjetra.

Sistemi shoqnuer i sotshëm, asht ai i sa 'mij vjetëve, i ndryshuem disa pikë, por aq pak, sa që nuk bie në sy.

Bota ashtë e ndame në kontinente, këto në shtete, shtetet në qytete e krahina, derisa mbrijmë ke njeriu e ke idetë e tij. Pasunia, që asht pikë e mbështetjes së të gjitha veprimeve, asht damë keq (hapi sytë sa të duesh, kapitalist!).

Njeni nga ne ka miljarda, n'sa tjetri nuk ka
asnji dysh. Disa kanë tokë gjana për mbjellje,
n'sa t'afërmit e tyne nuk kanë as bukë (bukë, them,
të hanë!).

Thonë që asht zhdukë skllavnia. Jo, nuk asht zhdukë, por ka marrë nji trajtë tjetër, atë të r-dihmës. Në vend të kamxhikut të drejtuesit të robve asht penda e bankierit; në vend të kasher agait asht polici që regjistron gratë publike, viktimë të vorfnisë dhe të padreitësisë së shoqnisë.

Nuk flas pér shpatat e jenigerëve të zavendësueme me karrigen elektrike.

Të gjitha këto i kemi trashëgim prej kohëve të kalueme, pse e kanë burimin në ndamjen e pa-suni.

Tishte pasunia e ndame me drejtësi, barbar, e të punojshin të gjithë njerëzit e botës për nji qëllim, sa e ndryshme do tishte jeta! Statistikat zyrtare diftjojnë haptas se gjaksinat ma të tmerrshme, vjedhjet ma të mëdha, kanë pasë shkak vohëkasinë.

Prej k ndej shohim se asht gja e domosdoshme t ndryshojm  ndamjen e sotme t pasunis  (gja e vjet r ) e ta zavend sojm  me nji ndamje



të drejtë e të njinjishme (gja e re.) Rusët e kanë ba që me kohë; shembull ëky se e vjetra shembet. Edhe ne do ta bajmë.

Të shofim fenë, opiumin e popujve.

Në kohnat e vjetra populli nuk i kuptonte këshillat e drejtuesve të tij. Për me e ba arabin të lahej e t'i paguente taksa Kalifit, ishte nevoja e nji Muhamedi që t'i predikonte popullit injorant se asht (ekziston) nji zot që i çon në xheqhem ata që nuk lahen, që nuk bajnë gjimnastikë, e nuk lajnë rregullisht taksat. Deri këtu asht mirë. Por të shohim këto të tjerat.

Nën maskën e këtyne rregullave sa e sa po-shtërsina u banë! Sa e sa herë turma e popullit, e qorrue me prej drejtuesve të fesë së saj, u bante robnues i nji tirani: «Jepni Çezarit c'asht e Çezarit e Zotit c'asht e Zotit».

Sa bukur e diftojnë këto fjälë qëllimin e fesë! Ku ka nji kishë, aty ka nji mbret.

Shekulli XX po e shkatërron të vjetrën. Në vend të saj shton shkollat laike, të majtuna prej shitëtit, plotëson biblioteka, lavron shkencat (animiket ma të mëdha të fesë: ku je, Galilej, para turrës së druve?) Shndërron kishat e xhamit në muzeume antiklerikale.

Të vijmë ke arti.

Arti i deritanishëm, që veç trajtës së bukur nuk ka tjetër cilësi, nuk i përbush nevojat tona. C'më duhet mue nji poezi e bukur në trajtë, por e vortën në ide? Nji pikture me copa të bukurë, por pa ide?

Poezia e sotshme nuk ka aq bukuri të trajtës, sa t'idesë. Mos kërko në kuadroi moderne gra të

bukura, skema idiliqe, shenjtore të rrrethuem me ngjyra të gjalla, mundimin e nji hamalli kur ngre nji arkë të madhe mbush me... shishe shampanje. Tulli po shqiptarët do ta rrënojmë të vjetërën.

Edhe na shqiptarët do ta rrënojme të vjetra. Mbi të do të ngrehim madhënisht flamurin e kuq tăllaznimit, të kulturës e të pasunisë¹⁾.

Kemi besim ně vevete, prandaj gëzomé.

Kemi besimi e qetësi
Asht zemra e një të riut pesëmbëdhjetvjeçar
që ju flet.

Shkodër, më 19 qershauer 1935.

D) në veshtrimin: të begatisë

Eshët një nga hartimet e Qemalit, shkruar më 1935, kur ishte nxënës i klasës së pestë në gjimnazin shtetëror të Shkodrës.

Tema e hartimit u nxuar nga dy vargje të dramës «Vilhelm Teli» të Frederik Shilerit, të përkthyer nga Skënder Luarasi që aso kohe jepte lëndën e letërsisë në klasën e Qemalit.

Hartimi u lexua në klasë dhe bëri jehonë ndërmjet nxënësve të gjimnazit. Nxënësi 15-vjeçar u thirr në drejtorinë e shkollës dhe iu tërroq vërejtja. Dijanë 15 maj 1949

Në këtë hartim të shkurtër Qemali zbulon pjeturinë e tij të parakohshme si revolucionar komunist. Ai zbulon urejtjen e madhe për regjimin, shtetin, klasat shqiptare dhe dëshirën e tij më të madhe për ta shembur këtë godinë të kalshur. Hartimi tregon se sa i përparruar në mendime ishte heroini dhe poeti ynë, se sa mirë kishte përvetësuar ai dijet shkollore dhe se si ishte në gjendje t'i përdorte ato për interesat e popullit dhe të revolucionit.

— Ku shprehet në këtë hartim besimi i Gjermanit se tota e re do të lulëzojë?

— Shpjegoni rrashthin e fundit qe mbylli nartimin zemra e një të riu pesëmbëdhjetëvjeçar që ju flet».

QORTIMET E VJESHTËS



E shihja cdo mëngjes, kur shkoja në shkollë.

Gjithmonë në të njajtën skutë, e njajta fytyrë zeshkane, e mbulume me lesh të gjatë, që lëshonte ngandonjëherë vezullime t'argjandta.

Vuejtjet ma tepér se koha, kishin lanë në faget e tij të vrazhda gjurmë të thella, të shumta.

Kujdeset e përditshme, të zakonshme, të vazhdueshme, kishin përfitue⁴⁾ fije të shpeshta të bardha në flokët e pakrehun.

Нé veré shiste pemé. Né dimén. gështea ié pjeckme.

Të gjithë fëmijët e lagjes e njihshin. Kurse shkojshin në shkollë, u ndalshin ke skuta e ngushët për me ble gësheja.

1) krijuar

Nganjiherë ndonji kalama i thoshte diċċa nē vesh. Atē ditē nana nuk i kishte dhanë tē holla. Burri tundte kryet e lodhun prej mendimeve. Dhe vente buzën nē gaz. Atē buzë tē thame qì rrallé kishte qeshë. Fēmija mbushte xhepin, me għesheja dhe u largonte i għeuem.

Dhe għeshtejepjekesi drejtonne shpinen e kerru sun prej lodhjeve kondent²⁾ pér għażi minn qeġġi.

* * *

Kur afrohej vera, atij i binte nji hija mjerimi. I vinte keq qeġġi u largojshin blesat e tij tē vegħiell.

Paret e humbuna?

Jo!

Ai copen e mjeri tē bukës dhe tē djathit pér vete dhe pér fēmijet (se kishte dy fēmijet tē bukur, tē bukur si pranvera) e fitonte edhe tue u shiġi tē miedhenjve pemē.

Por diċċa ndiente met-ċeċ, kur nuk shiħte buzże- qeshjet e kalamajve, qeġġ shkojshin me u mbyllé nē muret e rrebla tē shkollés, kur nuk digjonte zanet e għażu qeshme tē tyne.

Ai i shikonte ato fytyra engjällore, ai digjonte ato zane tē argjendta dhe i pērfytyrohej

2) i kēnaqur

kēnaqġesi kujtimesh tē ngahershme qeġġ zgħidha pa-pritmas, zane tē dashuna i flitħsin me ambel-Isi nē mēsheħtiesin ē e shpirtit tē tij tē mbyallun.

* * *

Fēmijet diftojshin shumē sende pér atē.

Kishte pasē dikur nji fēmijet, nji kérthi tē njom ġi dashunie, qeġġ me zanet e veta tē għażu qeshme binti lumtuni nē shtepin ē għeshtejepjekesi (pse kishte pasē edhe ai nji shtepi).

Nji ditē engjelli kishte lan ġi baben dhe nanen.

Nji jehon ġi vaji kishte pēr-shkue qetësin ē shtepis ċiex vorfni.

Prandvera e artē qeġġ shkimet¹⁾ e pakoh...

Rreza e mek-ċi drite qeġġ davaritet nē mjerim...

Ledhatime tē pafajjhme dashnie, qeġġ kēputen rreptësish...

Mbas disa ditēsh grumbulli i njerézve qeġġ kishte marrē kérthinin, kishte kthye...

Kishte marrē me vete edhe nanen ġi smut.

Mizori e pangopshme e gjaksore dħambiegħi!

Ma von ġi grumbull tjet-ċi njerézish me ar-marr dhe me rrobe tē njillojha, kishte qit-ċi tħalli shtepia, me pak irraġe mbas krahi, burrin ġi mjeruem.

Ai kishte mbet ġi vet-ċi, tmerrisħi tēvet-ċi, me dy fēmijet e lig-ċi dhe me mjerimin ġi vett.

At-ħer ġi kishte fillue me pjek ġi għesheja.

Nji ditē, kur po merrje għeshejat e zakon-shme, vērejha diċċa qeġġ mē ċuditi.

1) mbaron, shuhet

Gështejepjekësi kishte mbulue gjoksin e vet leshatak me nji rrobe të vjetrueme.

Ishëtë të ftohët, të ftohët kërcëllues nandori.

Ishëtë mëngjes, mëngjes i rebtë.

Binte borë e bardhë virgjënore, që flokë-flokë

Iëshonte mjerimin mbi kolibet e unjëta, dhe gëzim mbi pallatet e ndritshme...

Ishëtë dimën.

Kur më dha gështejat, burri u kollit. Fytyra i mori nji ngjyrë të zjarrtë. Pér nji çast vrulli u ul i përnjisherë njeriu u zvërdh... Shikoi dy fëmijët që po androjshin qetësish mbi dérrasat e vjetrueme të arkave të prishuna.

Dhe psherëtini.

Unë kuptova.

Binte borë. Ishëtë të ftohitë.

Mbas asaj dite ai u kollit shpesh. Zhurma e vrullshme e sëmundjes grise e ndaloi shpeshherë prej punës.

Burri vërente trishtueshëm fëmijët dhe vënte dorën në gjoks.

Nji ditë nuk e pashë ma.

Fëmijët, që blejshin gështeja u mjeruen.

* * *

Nji mbramje vjeshte këthejshe në shtëpi. Erë e rreptë e furishme frynte nga veriu. Binte shi, shi i ngritë. Tetori që shtin dridhjet në zemër.

Nën nji strehë gjysmë të shkatërrueme, strukë në pallton e vjetër.

Pashë nji burrë të këputun.

Kryet e thimë i mbështetej mbi gjoksin e ngushtë.

Në kocat e prehnit të tij pushojshin dy krena të vëgjël.

U afrova.

Gështejepjekësi me dy kérthijtë!

Flejshin tue u dridhë.

Deshë të flas.

Por nji ndijese e çuditshme më urdhënoi mos me e prishë atë qetësi mjerimi.

Dhe unë u largova i poshtënuem, kur vërejta rrobet e mijë të ngrohta.

U largoya me nji premtim dhe nji dënim në zemrën time.

Dënova shoqnië njerëzore, premtova...

Ishëtë imbramje vjeshte. Binte shi. Frynte erë.

Eshëtë një nga hartimet e Qemalit, shkruar në formë skice letrare në tetor të vitit 1936, kur ishtë nxënës i klasës së gjashtë në gjimnazin shtetëror të Shkodrës.

Qemali e dërgoi pér botim në revistën përparimi të Korçës «Bota e re», ku u botua në numrin e shkurtit të vitit 1937.

Edhe te kjo prozë shkruar në një hartim shkollor, Qemali zbulon dashurinë dhe respektin e tij të thellë pér njerëzit e varfër e të vuajtur. Këtë njeri të mbaytur nga hallet dhe skamja, Qemali e jep me bujarinë dhe pastërtinë shpirtërore që ka ai.

— Vini në dukje pjesët ku shprehet dashuria e Qemalit pér këtë njeri të varfër por me zemër të madhe.

— Ç'kuptim kanë fjalët: «Dënova shoqërinë njerëzore, premtova...»

NËNSHTYPJE KALTËRSIE



Mbi valët kryeneqe që lëkundin si fëmijë barka rrëshqet ledhatuese.

Zhurma monotone e makinave të fuqishme shënon ritmin e shpejtë të kohës që kalon.

Dielli i korrikut, i egër, i zjarritë, i jep shkëllime kristaline shkumës bardhoshe që shfren deri në zemrim.

Mbështetun mbi parmakët e pastër, nji detar i nximë më buzëqesh miqësisht.

I afrohem. E përhëndes.

Dora e tij e gjanë dhe e mësueme me tërhjekë pesha të randa, shtrëngon timen që ka humbë gjurmët e fuqisë.

E pyes.

Mbi fatin e pasigurt të jetës së tij të mundimshme.

M'u përgjegj.

Me za t'ulët, por energjik. Me fjalë të thjeshta, por që mbyllin nji botë.

E do detin e madh.

E dashunon si fëmija nanën në vjetët e para. Si fshatari tokën jetëdhanëse.

E njeh detin.

Më tregon vargje të pambarim që trondisin.

Më përshkruen episode të shumta mundi dhe djerse...

Nganjihërë fytyra e tij masive errësohet përi nji çast.

Asht kujtimi i ndonji shoku të vjetër, humbün në dallgat pa fund të detit të pangopun.

Por prapë sqarohet. Buzëqeshja klasike ndrit përsëri fytyrën e tij të celun.

Dhe vazhdon gjithnjë të tregojë vjejtjet e gjata që e kanë shtypë dhe e shtypin; mundjet¹⁾ e panumërtë që i tregojnë fatin e jetës.

Mustaqet e thime varen qëtësishët dhe dridhen nganjihërë.

Avullorja rrëshqet e qetë dhe madhështore.

Detari plak flet...


Duhet të largohem nga ai. Buzëqeshja e tij më thëtshit.

E dëgjoj me kureshtje, me dashuni.

Por jo me mëshirë.

Ai nuk kërkon mëshirë. Porsa dallon nji gjur-

1) mundimet



më të lehtë këqardhjeje mbi fytyrën time, qesh dhe këndon me za.

Përmes gojës së tij më flasin mijëra burra, që bajnë të njajtën jetë. Nëpër buzët e tij më qeshin dhe më këndojnë mijëra fytyra, që errësohen nga të njajtat kujtime.

Qenie të përvuejta, që punoni pa pushue në nji fushë që bota e kujton të gëzueshme. Burra të fuqishëm që keni trajtue me mund musklat e ngrehuna. Nuk keni nevojë pér mëshirët e plagët e njerëzve gjumashë.

Nuk njiheni.

Punoni në heshtje, kur të tjerët pushojnë.

Vëtëm ngandonjëherë nota e gëzueshme e njifizarmonike të motshme bie një tingull hareje në jetën tuej të zymtë.

Bashkë me kujtimin vegimtar të dy syve të zës, që ndritte si deti i gjanë nën qiellin e korrikut, si ai deti mbi të cilin ju pushoni natë e ditë.

Skicë letrare, shkruar kur Qemali ishte nxënës në gjimnazin e Tiranës. E botoi në gazetën «Shtypi», 5 shtator 1937.

Në këtë skicë letrare vëmë re respektin e thellë të Qemal Stafës pér njerëzit e punës. Ashtu si dhe në krijimet e tjera dhe këtu del para nesh bukuria shpirtërore e njeriut punëtor, të fortë, që e urren mëshirën. Kuptohet që të tillë njerëz qenë ata që i përforconin Qemalit forcën e papërbajtur të popullit.

— Si jepen në këtë skicë tiparet e klasës punëtore shqiptare në vitet kur shkruan Qemali?

— Gjeni vendet ku Qemali zbuloi madhështinë e njeriut që kan detef dhe oqeanet:

— Përgjigjuni me shkrim; — Si jepen njerëzit e popullit në krijimet e Qemalit?

SHEGERTI I VOGËL

Asht mëngjes.

Para derës së nji shtëpie përdhecke, i ulun mbi një gur, rri mendueshmë nji çun i vogël.

Trupi i tij i mpitë të difton çiltas se asht nja dymbëdhjetë vjec. Ka të vëshme disa rrobe të vjetra, të arnueme aty-këtu, por më kujdes e të pastra.

Ja mbulojnë kambët nji palë opinga të kuqe, prej gome. Fytyra e tij e shqetësueme shfaq se i ka ndodhë nji fatkeqsi asaj zemra ende të njomë.

Ka mbështetë kryet në dy grushtat e tij të vegjël dhe bërrylat në kupat e gjujeve dhe rrin njashtru i zhystun në mendime të thella.

Cas në ças ngre kryet e, si i zgjuem prej ndonji gjumi të randë, i drejton dy syt' e tij të zez kah dera e shtëpisë përdhecke...

Në nji shej kohe ai ngrihet e, si të ketë vendosë ndonji send, fillon me ecë.

Rrugës shikon andej e këndejej ndër dyqane, mendon e prapë vijon rrugën...

Ka kalue nji copë rrugë, kur ndalohet përpara nji dyqani, hedh nji shikim brenda dhe hyn.

Djaloshi përshkohet) nëpër dy rreshta tha-sësh, arkash e teneqesh dhe, tue shikue gjithë ato kosha me pemë, ato mure të nxime të thuesh prej koshës së dëshmi, ato sergjia¹⁾ gati të shkafërueme, i vete syni ke nji burrë i gjatë, me disa rrobe të ndyeta, me do mustaqe të gjata, e me nji fytyrë zeshkane e në krye nji qeleshe të zezë jo të vjetër, po të ndyet, me nji gjoks të gjanë që e mbulon nji këmishë e murme; prej brezit i varet nji mafrë²⁾ e madhe e kuq-mbyllë e plot njolla, që mbështetet plotësisht përmbi pantallonat e rrullshun. Asht ky Alush aga: nji burrë nga pesëdhjetë vjeç e i zoti i dyqanit. Qunit të vogël, tue u gjetë para ktij njeriu, zemra i ndrydhet e nji përgjethje e mprehtë ia përshkon shtatin pse shokët e tij i kanë thanë që Alush aga asht njeri i egrë dhe nuk i merr me të mirë djelt e vegjël. Por çuni i vogël, tue lanë në njanën anë këto mendime, i uron Alush agës mirëmëngjesin.

Ai, pa i përgjigjë urimit, me nji farë përbuzje e pyet se c'don.

— Due... kishje me dashë...

— C'ka? — i thotë Alush aga, tue e përkulë shtatin paksa përmbi çunin.

— Kisha me dashtë me u vendue shegert me zotninë tande — përgjegjet çuni i vogël me nderim.

Alush aga drejtohet rrudh vetillat e tij të trasha e mendon...

Mbas një grime, tue e shikue ç'prej majës së kresekë deni në fund të kambëve, e tue tundë kryet ia nisi me folë:

1) përshkon, kalon

2) rafte

3) shami

— A kishe me i ba punët e dugajës¹⁾ ashtu si të due unë?

— Si urdhënon, deri ku të mundem kam me bëmos që me i krye mirë.

— Mirë, pra, po e bajmë provën sot. Kaam me të dhanë për të parën ditë 2 lekë, mbasandaj ta shohim. Si të duket?

Çuni i vogël pranon, e mbasi hjekë xhalketën, fillon me punue...

S'pari merr fshesën dhe fshin dyqanin, mbasandaj me nji pecë ia nisë me shpluhunue sergjité e sendet e tjera, dhe kështu njanën mbas tjetrës i kryen punët e dyqanit ma së miri.

Alush aga, t'i porositmen nji pune, menjihërë i thotë me ba këtë tjetren. Për gabimin ma të vogël ai e qorton me fjalët ma t'ashpra, me shamjet ma të pabajtshme.

Por shegerti i vogël i kryen urdhnat e i ban të shemet e mjeshtrit të vet, pa ba vër me gojë.

Alush aga vetë çuditet për këtë djalë që punon me kaq zell dhe i ban fjalët e tij c'mos kurri nji tjetër.

Ai sheh n'atë qenie të vogël diçka të jashtë-zakonshme, që e cilson dhe e ban me mendue thellë për të.

*

*

Kështu kaloi dita, nji ditë në të cilën dyqani i Alush agës mori nji pamje tjetër: gjithçka ishte në rregull, e pastër.

1) dyqanit

Ndërkaq dielli dalëkadalë po prendonte për me i lëshue vendin natës, që porsi ndonji zonjë e randë po vinte prej lindjes...


Qielli kishte marrë nji ngjyrë të purpurt dhe u dukte porsi nji kupë e artë...

— Në qytet u shikte një lëvizje e madhe: Lëvizja e zakonshme që qyteti ka në mbramje.

Njatje vonë, kur Alush agës iu mbush mendja se nuk kishte c'me i urdhnue ma çunit të vogël, e thirri e tue e shikue në sy, i dha dy lekët e premtuem e i tha të shkonte.

Çuni, si përshtëndeti me nderim mjeshtrin e vet, u vesh, duel prej dyqanit, e me hapa të shpejtë u drejtue kah rruga ku u gjindte shtëpia përdhекe...

Ekte shpejt e pa i vue vesh kujt. Për të kot u ikundshin shreglat,⁴⁾ kot kndojshtin vashat me zanin e tyne t'ambël. Ai kishte vec nji mendim: shtëpinë përdhecke. Ekte e ecte, u dukte i vetëm, por mbrapa e kishte Alush agën, që i çuditun prej prumit të tij, i ishte vue mbrapa dhe e ndiqte hap mbas hapi.



1) kolovajzat, lëkundset

Mbrrijti, kapi dorzën e derës, e shtyni lehtë dhe në majë të gishtavet iu afrue një shtrati t'unjët, shikoi me vëmendje dhe tue i afrue buzët e vela të njoma, i mbësheti përmbi fytyrën e thatë e të vdekshme qì u gjendte aty.

Mandej nxori dy lek t prej xhepit, i vuni n 
dor n e lig sh  t  grues s . smuet, dhe i tha:

— Qé nané, qé fryti i mundit tē parē qé une
derdha pér ty... .

Eshtë një nga hartimet e Qemalit, bëre si detyre shtetore kur ishte nxënës i klasës së pestë të gjimnazit shtetëron te Shkodrës (1935). Kemi të bëjmë me një tregimt me subjekt që dëshmon për talentin e hershëm letrar të Qemalit nxënës

Në këtë prozë del përpëra nesh shirytezimi dne shtypjet kapitaliste që ushtruhej në vendin tonë gjatë viteve të rendit feudo-borgjez. Në qendër të tregimit është portreti i shegertit të vogël, që qysh fare i njomë shtypet e grabitet nga klassa e Alush agës. Qëmali shpreh qartë tiparet e larta të njeriut të thjeshtë dhe në kontrast me të, fytyrën shtazarake të tregtarit.

— Si jepet në këtë tregim realist portreti i klasës shfrytëzuese?

— Në c'pjesej tē hartimit vihet nē dukje virtuty i njerau tē varfér, po punētor e tē ndershém?

— Duke patur parasysh edhe pjeset e tjera ananazoni ne formë të përbledhur se si Qemali e shfrytëzonte qdo hartim për të shprehur idealet e tij revolucionare.

BREEZE FRENGJIJASH



Nji fytyrë e verdhë midis katër muresh të zeza: nji shpirt i munduem, në nji terr humnereje.

Krusun mbi tryezën e palatueme, grushtat
në tamtha, ai fluturon në mbretnitë e arta të kuj-
timit.

E kaluemja, ajo kohë e lirë e gjëzueshme, merr në ikujtesën e tij njimijë trajta të ndryshme: prej largësisë zbukurohet, përkryet, le mënjanë të metat, grimcat e vogla e të pakuptim.

Frëngji — dritare të vogla me hekura, pa xhamë

Barka e fildishtë e kujtimeve të tij lundron mbi një ligen të qetë, ligen gjëzimesh e hareje.

Brethue prej familjes, midis zanesh targjandta gjimi të fëmijëve, ai ledhatonte kaçurrelat e arta, puthte mollzat e trandafilda, jephte këshilla të vlefshme, rrinte në krye të tryezës:

Atë i lumtun!

Shoqnue prej miqshi, midis zhurmës së kafes, qesh prej shakave të ndonjenit, bisedon pér çash-tjet shoqnore, pranon, kundërshton:

Shok i dashtun!

Shetit, kcen, nget pa mendime, ulet, pushon ndër fusha të blerta, lëmon barin e porsa mungulluem:

Pranverë, I LIRE!

Jeton.

Jeton përsëri atë kohë, të ndritun prej sa e sa drithash të shkëlqyeshme: janë drita lirie... drita lumnie fantastikë...

... Kur kujtimi i tij merr hovin ma të madh kah koha e kalueme, nji tingull metalik, i holë, i shtyem përshkon qetësinë e ftohtë që e rrëthon.

Dera e vogël e hekurit u çel.

Nji dorë e zezë le prej nji vrime nji copë bukë të zezë dhe nji kupë ujë.

Njeriu trendet¹⁾. Shikon përreth: heshtje varri.

Në vend të kagurrelave t'arta të fëmijve të vet, ai kishtë rrathët e ndryshkuna të prangave të randa.

Nji fytyrë e verdhë në mes katër muresh të zeza dridhet.

Nji shpirt i munduem në nji terr humnereje gandohet¹⁾.

Dritsorja e vogël, përshkue prej hekurash, lëshon nji dritë të mekun: I BURGOSUN.

Me pjetkuri të madhe Qemali zbulon në këtë shkrim faktin se koha e Zogut, rendi feudo-borgjez mbyste qdo liri shoqërore, pér fjalen a veprimin më të vogël përparimtar, njerëzit ndrysheshin në burgje. Autori zbulon botën shpirtërore të këtij të burgosuri në qelitë e errëta.

1) tronditet

1) lëndohet

SKAMJE



Mbi rrugën e drejtë që çon në fshat, ata udhëtojnë ngadalë.

Ai, i hypun mbi kalë.

Ajo, prapa tij, ecën në kambë.

Në dorë ka opingat e kuqe që vlejnë për ditët e pazarit. Pse qyteti nuk pranon njerëz të zbatun...

Me hap të shpejtë ajo mundohet të ndjeki ecjen e shkathët të kalit të burrit të saj.

Nganjiherë, nën djegien e egër të diellit fusharak ajo shikon ftyrën e dashun të të shoqit, të zotit. Mustaqet e zeza nuk e kanë humbun aspak dredhjen kryeneçe të vjetëve djaloshare. Ftyra e drashtun i ruen gjithnjë vijat e squeta të kohës së parë martesore.

Ajo shkon nëpër mend vjetët e kalueme bashkë me atë.

Sa ngjarje! Sa vuejtje!

Po gëzimet?

Mundohet të kujtojë ato rastet e vogla, dasmat e rralla në të cilat kërcente bashkë me shoqet kur ishte e re.

Një dridhje ia përshkon zemrën...

Sa të paktë...

Por ato ditët e rralla vlefshin për atë sa një botë. Pse atëherë dy sy të tjerë, dy sy të zez e vërejshin midis të tjerëve.

Ajo e ndjente veten të lumtun kur mund t'u përgjegjej.

Ma vonë, ai e mori. Shtëpia e re iu duk e madhe në krahasim me të sajën.

Filloi një jetë tjetër, një jetë të përulur, mbushë me sakrifica.

Kështu jetoi sa vjet!

Me gishtat e dorës mundohet t'i numërojë.

Sa vështirë!

Kambët e shkathëta të kalit ngrajnë një re piuhuri mbi rrugën e drejtë.

Ajo mpron sytë me dorën e vrashhdë.

Dielli fusharak djeg pa mëshirë natyrën e flejtun.

Vëreni në këtë skicë të shkurtër se me sa dashuri e përshkruan Qemali fshatarin tonë të vusajtur dhe nevojtar. Ai zbulon kontrastin e madh midis fshatit dhe qytetit.

— Ç'kuptim ka thënja: «Në dorë ka opingat e kuqe që vlejnë për ditët e pazarit. Pse qyteti nuk pranon njerëz të zbatun...»

TE DY...

Vepra lodhëse e kohës u ka kërrusun shpinat e mësueme me bajtë peshien e vjetëve.

Lotët e derdhun me gurga u kanë sgavrue¹⁾ gropat e syve të mësuem me qa.

Vuejtjet e pësueme u kanë shenjuem rrudha të shumta, të shpeshta.

Tërhekin me vete barrën e randë të qenieve të tyne të veshkuna.

Ecin ngadalë, tue matun hapat.

Dritat e bulevardit shkëlqejnë si shpresat e arta të djalërisë së tyne të kalueme.

Të dy vërejnë me kureshtje botën e huej, që u lëviz përqark.

Sa e ndryshme asht prej botës që ata jetuen!

Të bashkuem prej shkopit të lëmuet, shikojnë me frikë gëzimin e njerëzve që u shkojnë pranë.

Lodhun nga rruga e gjatë e plot pluhun ndalen në cepin e trotuarit.

Aty mund të vërejnë të tjerët me qetësi... pa u bezdisë.

Të ulun mbi gurin e stohtë, i kapin dorën njëni-tjetrit si përkëdhelje.

1) nga zgavër; thelluar



Dhe qeshin.

Rrudhat e fytyrave thellohen.

C'dritë e artë i ka depërtue dy zemrat e lodhuna?

Ndoshta kujtimi i çastit të pangurtë kur, të frikshëm dhe dyshues, banë për të parën herë premtimet e ambla...

Ndoshta kujtimi i lodhjeve të shumta, i vërejtjeve të shpeshta, që u kushtoi jeta...

Nuk e di.

Ata qeshin.

Dritat e ndritshme të rrugës shkëlqejnë si shpresat djaloshare.

Në këtë skicë vemë re dashurinë e Qemalit për njerëzit e thjeshtë e të varfër të kërrusur nga hallet dhe pesha e vitezave. Pleqëria e tyre është e rëndë. Ata kujtojnë rininë e tyre kur ishin të fortë dhe përballonin diçka.

— Në cilat pjesë të skicës shprehet varfëria dhe vuajtja e këtyre njerëzve?

— Bëni një hartim me temë: «Si jetonin të moshuarit në regjimet e mëparshme e si jetojnë sot».

SHKRONJAT «SHPËTIMTARE»



Në nji skaj të harruem të Pazarit, nji dyqan gjysmë i shkatërruam. Para tij ishte ulur këmbë-kryq mbi arkë, nji trup i kërrusun. Mjekra e parregullt difton se asht hoxha i lagjes sime.

Cdo të enjte gjendet aty.

Katundarët e mirë, që kanë halle, e rrethojnë me nderim.

Me za të unjët, monoton i diftojnë dhembjet e ndryshme që u ka dhurue «Zoti».

Hoxha tund kryet: çon mbi vetullat e trasha qeleshen e ndytë. Me ftohtësi ngjyen pendën me bojë të zezë.

Dalëngadalë rreshton shkronjat «e mrekullueshme».

Asnjeri nuk e kuption. Jo, gabova. Vëç fuqisë së errët, që e mëshehum në ndonjë skaj të botës «mbinjerzore», «drejton» fatin e tyne të durueshëm.

Atyne mjafton t'u dëgjohet urdhni i heshtun.

E shkronjat «e shenjta kanë shërue» varrët jetike të fisit.

I marrin rripat e gjatë të letrës «së mrekullueshme». I palosin me kujdes në trajtë trekandëshi. Me adhurim i venë në kutinë e duhanit.

Pranë shishes së hollë të bojës së zezë janë ndonji pare.

Pse fuqia e errët «e gjithëpushtetshme» kërkon të drejtën e vet.

Grumbulli i katundarëve (bashkë me disa qytatarë) madhohet. Pëshpëritjet shumësohen.

Hoxha shkruen...

korrik 1937

Në këtë skicë demaskohet roli reaksionar i fesë dhe klerikëve që gjenjen popullin e varfér e të pashkollë dhe u zhvatin edhe ato pare të pakta që kishin.

— Si e demaskon autori këtë hoxhë hilegar?

— Përse shoqëria jonë e sotme nuk beson në usnjë forcë të fesë?

V J E S H T U K Ě T

Rruja që çon në shkollë ka fituem përsëri gjallërinë e ditëve mësimore.

Por këtë herë jo prej nxanësve të zakonshém, por prej atyne ma karakteristikë: të riprovuemit në vjeshtë.

Me hap pak si ngurrues, ato dhe ata drejtohen kah shkollë. Asht dita e gjyqit. Duhet me paguem hesapet e nandë muejve tallëse dhe gazi...

Atje, në shkollë, që tash merr ngjyra vorrezo¹⁾ presin profesorët: disa me buzëqeshje, disa me ngrehje triumfuese. Natyrisht kanë të drejtë. Vetëm ata e dinë se ç'kanë hequn prej vjeshtukëve²⁾ dhe vjeshtukeve.

Qe, bisedojnë me za t'ulët me njani-tjetrin, me njana-tjetren.

Nën sisetull kanë librat.


Disa qeshin. Disa janë të murrtë.

Të gjithë kanë diçka pér të diftuem.

E nën kërcënimin e frazave gramatikore dhe

1) prej vorrit, të rënda

2) nxenësit e mbetur me provim në vjeshtë.



ekuacioneve algjebrike ata dhe ato shprehin frikat e tyne: me pesë minuta humbet ose fitohet nji vit.

Ora asht tetë. Në oborrin e gjanë para shkolles, mblidhen të gjithë. Mbi derën e brendshme shpalljet e daktilografue me lajmërojnë provimet e ditës.

Vjeshtukët dhe vjeshtuket afrohen.

Tufa-tufa bisedojnë me gjallëni.

Por pér nji çast zanet heshtin.

Në derën e madhe duket një profesor.

Pa i vuem në rregull (pse vjeshtukët dhe vjeshtuket nuk njohin rregull) i çon ndër rendet përgjegjëse ku gjenden komisionet provuese.

Me kokë t'ulët nxenësit hyjnë. Tashti asnji nuk qesh. Të gjithë janë të thelluem në kujdesin e frikshém të temës së provinit.

Ata dhe ato, që gjatë vitit ishin aq të gëzueshm!

Në këtë skicë me një ngjyrë të lehtë humor, Qemali kritikon nxenësit përtacë e jo seriozë që mbeten në vjeshtë dhe humbin një vit fort të vlefshëm.

— Ç'dini pér Qemalin nxenës?

— Përse Qemali tallet me vjeshtukët?

— Ç'mësime nxjerrim nga kjo skicë?

U rritëm afër saj, pak ka pak nxuem prej saj
me i njohtun sendet, me u dhanun atyne nji emën
e me dashtun njerëzit.

Nana na mësoi me thanun ATDHE, e me e
dashtun me gjithë zemër...

Shkodër, 1 tetor 1934

NANË



Nanë! Ma e ambla, ma e dashtuna, ma e mira
fjalë që del prej zemre, ma e para që kemi nxau-
nun, fjala që e kemi shqyptue mun ndër çastet ma
të vështira të jetës e ndër gëzimet tona ma të më-
dha.

Nanë! të gjithëve kjo fjalë u paraqet një fy-
tyrë të ambël e të gzheshme, atë të nanës sonë që
na ka falun jetën, që na ka dashtë e kuptuem edhe
kur ishim në djep e nuk dishim me folun; qysh
atëherë për atë ishim gjaja ma e mirë, krijesa ma
e bukur që u gjindte në botë.

Eشتë një nga hartimet e para të Qemalit, shkruar në
klasën e katërt kur ishte nxënës në gjimnazin shtetëror të
Shkodrës. E botoi në revistën e fëmijëve «Vatra e rinisë».

Edhe në këto pak radhë të kësaj skice duket me ç'kuptim
të lartë shoqëror e patriotik e nderon Qemali nënën.

— Shkruani një hartim me temë: «Si e qmoj unë nënën
time».

QELLIMI YNE


Në të gjitha vendet e botës, në kohna kalimi prej nji gjendje shoqnore në nji tjetër, prej nji shkalle kulturale në nji tjetër, prej nji sistemi ekonomik në një tjetër, rinia ka luejtun nji rol shumë të randësishëm në drejtimin (për sa i ka përkittë) e popullit kah jeta e re e dishrueme, i ka dhanë këshut nji ndihmë me të vërtetë të madhe evolucionit, që gjithmonë ban rrugën e vet.

Shembuj historia na jep mjaft.

Mjafton me përmendë studentat heroikë të revolucionit të Francës, që me punën e tyne kontribuen shumë në të trajtuemit e ndërgjegjes kolektive, në të organizuemit e mënyrave të reja të jetës.

Edhe na të «Shkëndisë», atë do të mundohemi të bajmë. Pjestarë të nji breznie që prej errësine don me dalë në Dritë, na do mundohemi me Shkëndinë tonë të vogël me dhanë ndihmën e kërkueme prej studentave në Veprën e madhe të naltësimit menduer dhe landuer të Kombit tonë.

Jemi të birtë e popullit. Si të tillë, i kemi përditë parasysh nevojët e tij, të metat e tij, gjendjen kulturale të tij. Për këtë arsyen nuk mund të diftoheni të huej përpara problemeve jetësore të tij.



Në shtyllat e revistës sonë modeste do të mundo hemi me e lodhë edhe na menden tonë mbi këto probleme. E dimë se shumëkushi ka me vue buzën në gaz me ironi kur të këndojojë këto radhë, por na jemi të sigurtë se ai ka me u pendue menjipherë kur të shfletojë krejt revistën tonë. Në faqet e reja, të revistës sonë të re kemi me u mundue me paraqitësa ma të qartë, në të tanë formën e vet, në të tanë singeritetin, ai asht karakteristikë, e tij, mendimin e studentit rrëth problemeve tona.

Jemi të rrij. Prandaj na mendojmë se vetëm të rrijtë mund të krijojnë një shoqni të re shqiptare. Kjo nuk na ndalon që pleqve t'u kemi detyrë nderimin e flokëve të argjandta. Na mendojmë se të vjetrit kanë nevojë për pushim.

Vetëm të rrijtë mund t'organizojnë nji shoqni të re shqiptare. Thomi të rrijtë, pse, tue mos pasun lidhje me të shkuemen; vetëm ata janë në gjendje të shikue çashqitjet me syun e kohës sonë. Thomi të rrijtë, pse vetëm ata janë në gjendje me i shi në punë energjitetë e tyne të reja për nji punim sistematik, pse janë të zhveshun prej mbeturinave të kohëve të kalueme.

Në pikëpamje kulturale na kemi me u men-

due me i ba fletöt e revistës sonë nji elter¹⁾ të vërtetë të ditunisë, ku nuk nderohet tjetër veçse dituria, ku nuk adhurohet tjetër veçse kultura.

Në letërsi revista jonë ka me u mundue me paraqitë forma sa ma të reja e sa ma të bukura, me të cilat mund të mveshet nji mendim i drejtë dhe i naltë. Në «Shkëndinë» kanë me u botue, përvèç përkthimeve të pastra, edhe pjesë origjinale, prodhim i fantazisë së re, por të disiplinueme të studentit, tue qenë gjithmonë në përkim²⁾ me realitetin e jetës shqiptare. Zotësitë e reja letrare kanë me iu paraqitë publikut të madh me vargjet e shdërvjellta të shkrimitarëve të rij studentë, varge që i bijnë aromën e shenjtë të rinisë, prodhimin e zjarrtë të nji brezi që e ndien mirëfilli përgjegjësinë që ka përballë gjeneracioneve³⁾ të ardhshme.

Kritika kemi me pasun mjaft. Prej tyne nuk trembemi. Kemi me qenë gati me dhanë shpjegimë për çdo shkrim të botuem në revistën tonë. Kritikat e drejta dhe objektive kemi me i pritun me gjithë zemër pse janë shejë se shkrimet tona këndohen seriozishi. Të tjerave nuk kemi me u dhanë as randësinë ma të vogël, pse janë shenjë e nji karakteri të ulët, që kah s'mundet me veprue vetë, mundohet me gjuejtë n'ujë të turbull.

Punën e kemi fillue. A kemi me ia dalë? «Shkëndija», nji revistë e re organ i ri i një grupi të ri, ka me vazhdue punën e vet me gjithë penqimet që ka me ndeshë.

Asht detyrë e ytja, lexues fisnik, me e përkrahë.

Maj 1936

1) altar

2) pajtim

3) brezavet

Në vitin 1936 shoqëria «Besa shqiptare» e nxënësve të Gjimnazit të Shkodrës vendosi të botojë revistën «Shkëndija». Qemali mori pjesë aktivisht në përgatitjen e lëndës së revistës, ai e pagëzoi atë, hartozi planin e numrit të parë, shkroi skicën «Rreze frengjishash» dhe kryeartikullin «Qëllimi ynë».

Siq dihet, revista nuk dol.

Në këtë shkrim që do të viente si artikull prezantues për revistën «Shkëndija» del shumë e qartë pjekuria e Qemalit i cili edhe pse në moshë shumë të re kupton rolin e madh që duhet të luajë rinia në jetë e në përparimin shoqëror. Shkrimi ve në dukje vetëdijen e lartë të Qemalit, si e kuptonte ai detyrrën e nji reviste ndaj popullit.

— Lexojeni këtë shkrim me shumë kujdes dhe diskutoni radhë përradhë ato mendime aq të pjekura të Qemalit.

PORTRETI I SKËNDERBEUT



Çdo epokë historike e trajtueme nga kushtet ekonomike e shoqnone që e kanë parakalue e që jetojnë bashkarisht me te, shkakton lindjen e një vargu të gjatë fenomenesh, të cilat n'anë tjetër ushtrojnë një veprim ngadalësues ose shpejtues mbi zhvillimin historik.

Po t'i marrim njerëzit e mëdhenj, si pjellë e kushtevet shoqnone-ekonomike dhe historike - e arsyetimi ma fillestar na jep me e kuptuem - do të shohim se ata janë të lindun në një rreth të caktuar, kanë pasë një trajtim, i cili ka lehtësue veprimtarinë e tyne. Ata, njerëzit e mëdhenj të lindun në kushtet historike-shoqnone të dhanuna, kanë qenë shprehja ma mishnuese e aspiratave të

rrethit shoqnor në të cilin kanë lindë dhe kanë ushtruem një forcë mbi zhvillimin e ngjarjeve.

Prandaj, njerëzit e mëdhenj, që në realiteti nuk janë aq të mëdhej, duhen studjuar si gjithë fenomenet e tjera historike, politike e shoqnone, domethanë shbiruem rrethin ku kanë lindë, atmosferën që ka mbështjellë trajtimin e karakterit të tyne, vendin ku kanë zhvilluar të gjithë aktivitetin për të cilin ata cilësohen si të mëdhenj.

I studjuem nën kët prizëm, si na paraqitet Skënderbeu?

Dikush do të mejtojë se ftyra e këtij burri do të pësojë një humbje, pse e ulun në shkallën e njerëzve të zakonshëm.

Kjo nuk aspak e arsyeshme.

Randësinë e një njeriu, vlerën e një vetje historike nuk e përban fakti se ata nuk u ngjajnë njerëzve të tjerë, por pikërisht në këtë qëndron pika e zjarrtë e lartësimit të tyne; ata qenë njerëz që patën gëzime e idhnime, fatkeqësi dhe lumtuni, si të gjithë të vdekshmit.

Përndryshe do të arrijshim një nji divinizëm¹⁾ që, në vend që tu shtonte vleftën, do ti bante qesharakë si zotat e mitologjisë greke.

Të gjithë jetëshkruesit janë të një mejtimi mbi cilësinë kryesore të Skënderbeut: ishte një pris ushtrie i zoti. Legjenda pastaj na e zbukuron edhe ma tepër kur thotë se kishte le me shejë... Edukata që mori në oborrin e Sulltanit, luftat e vazhdueshme që bani kundra turqve, na provojnë këtë mejtim. Zot-

1) hyjnizim

sia strategjike e Skënderbeut përbahej nga tri cilësi kryesore: njohja e thellë e ushtrisë dhe e mjetave luftarake otomane, njohja e tokës dhe e psikologjisë së luftarit shqiptar, zotësia e organizimit.

Skënderbeu e njihte mirë ushtrinë otomane, pse që në fëmimi kishte marrë pjesë në ushtrimet luftarake të ushtarëve, që n'atë kohë i shqiptarit tmerrin botës evropiane. Kështu nga një kombinim dialektik që na ve me meje, vetë Perandoria e madhe osmane edukon nji princ të madh që dikur do të bahet armë kundër saj. Me shpresë se do të mundte me e shfrytëzuem në dobi të vet, pregatit një vegël kundra vetëvetes...

Prandaj Skënderbeu, tue njohë vlerën e ushtarëve osmanlli, organizimin e kuadrove të ushtrisë perandorake, dhe gjendjen e përpiktë të armatimit të tyne, mujti me i drejtue mësimjet e tij në mënyrë që mungesën e luftarëve të tij e zëvendësonte me përqëndrimin e fuqisë në drejtim të pikës ma të dobët të armikut, gja që e njihte ma së miri. Skënderbeu ishte nji princ i lindun në malet e Shqipnisë. Kjo s'kishte nji kuptim të zbrazët për te: kjo donte të thotë njohjen e vendit pllambë për pllambë.

E me të vërtetë Skënderbeu, bir i ndershëm i maleve të kësaj Shqipnie të vorfun, e njihte vendin e tij, pse Skënderbeu nuk ishte mbyllë në pallate maharaxhahash, por kishte jetuem në mes të popullit, në mes të fshatarëve të mirë e punëtor të kësaj Shqipnie tonë të dashun... Kështu, toka shqiptare nuk ishte për të vetëm nji fushë për me zgjanuem pasunitë, por ishte toka ku kishte lindë, ku kishin jetuem dhe ku kishin vdekë të parët e

tij. Edhe e donte kët tokë, e dashunonte me gjithë zemër, me zjarrin dashnues të nji djaloshit tetëmbëdhjetëvjeçar. Para se me durue dhunimin e vorreve të të parëve të vet, para se me pranue përuljen, ai pranonte me ba fli qetësinë e tij vetja-ke, atë të popullit të tij.

Mbas nji pricrit të tillë që ka jetue dhe ka vuejtë me popullin e vet, kush nuk shkon me vdekë!?

Pse populli, kjo masë e çuditshme, e zonja përmrekullitë dhe ballalleket ma të mëdha, vetëm në një vend asht i pagabueshëm: ai i njeh ata që e gë-njejnë, i gjykon dhe i dënon. Don me gjithë shpirt edhe vdes për ata që punojnë pa dallavere, në të mirën e tij.

Pika e tretë asht zotsia e organizimit. Asht e pamohueshme se potenciali luftarak i nji pakice të organizueme, d.m.th. e inkadrueme në rregull, e disiplinueme dhe e bindum, asht shumë ma e naltë se një turmë e madhe dhe e shkatërrueme.

E Skënderbeu e kish kuptue këtë të vërtetë: prandaj ai zgjidhët kuadrot jo tue u nis nga parimi i stërgjyshisë, por tue vërejtë trimninë, ushtrimin dhe zotsinë e drejtimit. Pse Skënderbeu zgjidhët oficerat vetë e pse nuk donte që t'ishin të vlefshëm vetëm për me ba paradë.

Nji anë gjer më sot e pagjurmue me mirë nga jetëshkruesit asht zotsia diplomatike e Skënderbeut. Jemi mësuem me e kufizuem admirimin tonë vetëm tek Skënderbeu luftar, të gjitha cilësitë e tjera kanë qenë të mbizotnueme nga kjo cilësi kryesore.

Por Skënderbeu si diplomat paraqet një interesi shumë të madh. Përveç disa sqarimesh mbi zotsinë e inteligjencën e vet, Skënderbeu na jep

holësi të mjafta edhe për kuptimin e pozitës politike të Shqipnisë së asaj kohe.

Kemi pamë anët kryesore të Skënderbeut, të Skënderbeut historik, të kapedanit trim që na pëlqen ta parafytyrojmë me trup të madh, shpatulla katrore e me mjekërr të gjatë.

Por Skënderbeu njeri? Skënderbeu fëmi, djalosh, dashunues, babë fëmijësh.

Këtë e lanë në heshtje jetëshkruesit egoistë të zatetun kryesisht nga dëshira të na paraqesin luftarin. Janë për tu studjuem çastet e idhimit, të dëshpërimit, të fatkeqësive.

Një njeri që të gjithë jetën e kalon në luftë të përgjakshme a nuk androi ndonjëherë me u gjetë pranë të vëtëve e me shijuem në një natë dimëri ledhatimet e Gjonit të tij të vogël, ngrohtësinë e vatrës familjare, ngushëllimin e fjalëve të ambla.

A por ky njeri, i reshun ndër lufta, nuk pati ndonjë çast ligështie kur pau bashkëpunuesit ma të mirë që e tradhëtuen, shokët e tij ma trima që rannë në luftë.

Kush i ka studjuem lotët e heshtun që ka derdhun Skënderbeu trim, larg fushës së betejës, kur mejtonte fatkeqësinë e vendit të tij. Pse Skënderbeu mejtonte çdo ditë me zemër, për të ardhmen e vendit të vet.

Po të zbulojshin ndonji epistolat të tijin, do të na viente për me njohë anën njerëzore të heroit tonë.

E do ta dojshim ma shumë Skënderbeun, nga zotitë e tij, nga trimnia e rrallë, nga bujaria e zemrës; nga roli historik që ka luejtë mbi fatin e Kombit tonë ka mbetë edhe asht një simbol.

Simboli i mundimeve të kombit tonë, simbol i "aspiratave të nji populli martir që vuejti gjatë shekujsh.

Maj 1939

I vetmi artikull me karakter studimor që na ka arritur nga Qemali. E shkroi në verën e vitit 1939.

U botua për herë të parë në gazetën «Zëri i rinisë» në 5 maj 1962.

Qemali e shesh çdo epokë historike nga kushtet ekonomike e shoqërore që e karakterizojnë atë. Edhe personalitetet e një populli i shikon si përfaques të klasave dhe botëkuptimeve të një epoke. Në këtë mënyrë, Qemali është ndër të parët që ka shfaqur një interpretim materialist dhe klasor për figurën e Skënderbeut, për rolin e tij përparimtar, përvendin që ze ai në historinë e popullit tonë.

Qemali synon me këtë shkrim që edhe historia jonë, ndryshe nga ç'rajtohej në shkollat e atëhershme, ta analizojë Skënderbeun si një njeri të thjeshtë, të zakonshëm si gjithë të tjerët, ta pastrojë atë nga hyjnizimet dhe legjendat. Pra, Qemali kërkon një histori materialiste.

— Si i zbulon Qemali tiparet njerëzore e kombëtare të Skënderbeut?

— Në ç'drejtume kryesore duhet zbuluar personaliteti historik i Skënderbeut?

— Si i zbërtheni tri radhët e fundit të këtij shkrimi?

— Ç'vepra të tjera për Skënderbeun keni lexuar? Ç'ju ka tërhequr te ato?

PËRMBAJTJA

	Faqe
Trashëgimi letrar i Qemalit	3
Hijes së tim vlla!	12
Shokut të prangave	15
Kanga e kumbonares	17
E vjetra shëmbet, kohët po ndryshojnë; një jetë e re po	
Iulëzon gërmadhash	20
Qortimet e vjeshtës	25
Nënshtypje kaltërsie	30
Shegerti i vogël	34
Rreze frengjish	39
Skanje	42
Të dy	44
Shkronjat shpëtimtare	46

	Faqe
Vjeshtukët	48
Nanë	50
Qëllimi ynë	52
Portreti i Skënderbeut	56